

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot, më datë 01.07.2019 (dymije e nentembedhete),

### SHITËSIT:

- Z. Amant Josifi** i cili zoteron 1 pjese te kapitalit te Shoqerise me vlere 100.000,00 leke (ALL) qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Dhe,

**BLERËSI: Shoqeria “APA - LIAISON” SH P K** shoqeri e themeluar me date 10/09/2012 me seli ne Tirane me NIPT L22111004P regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 11/09/2012 ( ketu e me poshte do te quhet “Bleresi”).

### Ekzistojnë këto kushte paraprake

- Rezulton se shoqeria “O R I T E C H “ shpk, eshte person juridik shqiptar regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) me date 13/09/2016 dhe pajisur me numer identifikimi NUIS – L62113035M, me kapital themeltar prej, 100.000,00 Leke.

1. *Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te te treteve me seli ne Shqiperi apo ne cdo vend tjeter qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise , duke respektuar ligjin ne fuqi. Te kryeje aktivite nepermjet telefonit te cdo lloji per llogari te vet apo te treteve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nepermjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe cdo lloj tjeter aktiviteti te lidhur me te pa kufizim. Shoqeria do te kryeje veprimtari edhe ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme online. Ne fushen publicitare do te ofroje sherbime te reklamimit te produkteve dhe sherbimeve nga individe apo shoqeri tregtare, sherbime ne fushen e komunikimeve elektronike, dixhitale, grafike, te medias etj. Te bleje e te shese ose te jape me qira ne perdorim, ne uzufukt ose ne perdorim pasuri te lujtshme e te palujtshme te rregjistruar ne rregjistrat publike.etj.*



**Ortaku i vetem i Shoqerise "O R I T E C H " sh.p.k, eshte:**

1. **Z. Amant Josifi** i cili zoteron 1 pjese te kapitalit te Shoqerise me vlere 100.000,00 leke (ALL) qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Me vendim te Asamblese se ortakeve te Shoqerise "O R I T E C H" sh.p.k, :  
në datë 01/07/2019 ortaket e Shoqërisë "O R I T E C H" sh.p.k, eshte vendosur :

- Shitjen e 1(nje) pjese te kapitalit themeltar te Shoqerise me vlere prej 100.000,00 leke (ALL) qe perfaqeson 100% te Kapitalit themeltar te Shoqerise, qe zoterohet nga ortaku Amant Josifi , tek Bleresi Shoqeria APA-LIAISON shpk
- Realizimin e Kontrates se shitjes se kuotave dhe plotesimin e te gjithë dokumentacionit te nevojshem per te bere depozitimet perkatese prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. (QKR).

**Neni 1  
Objekti i Kontratës**

- 1 Shitja e 1(nje) pjese te kapitalit themeltar te Shoqerise "O R I T E C H" shpk me vlere prej 100.000,00 leke (ALL) qe perfaqeson 100% te Kapitalit themeltar, qe zoterohet nga ortaku Amant Josifi , tek bleresi Shoqeria APA-LIAISON shpk..

**Neni 2  
Çmimi i shitjes**

1.1 Palët, bien dakort që çmimi total i shitjes së këtyre kuotave do të jetë:

- Shitesi Amant Josifi , i shet bleresit Shoqeria APA-LIAISON shpk pjesen e tij te kuotave te kapitalit 1( nje ) pjese qe perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise , kundrejt cmimit total 100.000,00 leke (ALL)



- 1.2 Palet deklaruan se pagimi i cmimit te shitjes se kuotave te kapitalit eshte kryer plotesisht nga bleresi, sot ne daten e hartimit te kesaj Kontrate dhe jashte zyres prane Qendres Kombetare Te Regjistrimit (QKR).

**Neni 3**  
**Kalimi i titullit të pronësisë**


- 3.1 Kalimi i titullit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.
- 3.2 Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- 3.3 Një kopje e kësaj kontrate shitjeje do të depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, (QKR) në mënyrë që të bëhet kalimi i menjëhershëm i kuotave në pronësi të blerësit.

**Neni 4**  
**Të drejtat dhe detyrimet e shitësit**

- 4.1 Shitësi mori përsipër, të njoftojë, garantojë dhe sigurojë Blerësin se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të Kontratës së mësipërme këto kuota:
- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor
  - Janë të bllokuara për llogari të të tretëve
  - Shitësi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
  - Dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj Kontrate, është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i fallsifikuar
  - Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota kapitali.
  - Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve .
- 4.2 Shitësi është i detyruar të paguajë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga blerësi. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve të Kodit Civil.

**Neni 5**  
**Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit**

- 5.1 Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësi do paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit etj...



- 5.2 Blerësi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 5.3 Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë, të palëve.

### **Neni 6 Zgjidhja e Kontratës**

- 6.1 Palët nuk mund ta zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.
- 6.2 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëaneshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontratës i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

### **Neni 7 Interpretimi i Kontratës në tërësi**

- 7.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

### **Neni 8 Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni**

- 8.1 Kjo Kontratë shitje, me objekt Shitje kuotash, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” .
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**Neni 9  
Njoftimet**

- 9.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkruar në këtë Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

**Neni 10  
Gjuha e Kontratës**

- 10.1 Kontrata hartohet në 5 kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

**SHITËSI**

**Z. Amant JOSIFI**



**BLERESI**

**Shoqeria "APA LIAISON" Shpk**

**Perfaq. Administratori Andi Zaimaj**

